


PROPOZIMET TEKNIKE PËR VOTËN E DIASPORËS

PROCESI I REGJISTRIMIT



KOMISIONI QENDROR
I ZGJEDHJEVE

Ilirjan Celibashi

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi




kqz.gov.al

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

Shprehja e vullnetit për të votuar nga atje ku banojnë, e zgjedhësve nga jashtë vendit, (këtej e tutje referuar si, regjistrimi i votuesve nga jashtë) – proces që do duhet të administrohet nga KOZ



kqz.gov.al



Elektronike

Mënyra e propozuar e regjistrimit



Biometrike

Teknologjia e përdorur për verifikim



Sistem online

i aksesueshëm nga zgjedhësit jashtë vendit si:

- aplikacion mobile në smartphone
- në web nga PC

*Në të dy rastet, pa kosto për zgjedhësin



Kjo mënyrë regjistrimi është aplikuar në:

Estoni, Gjermani, Kanada, Australi (New South Wales), France, Meksike, etj.




kqz.gov.al

PROCESI I REGJISTRIMIT

HAPI 1



OSE



Hap adresën/url në web nga kompjuteri me kamera

Zgjedhësi shkarkon aplikacionin mobile të KQZ falas që do të jetë i disponueshëm për sistemet e operimit Android dhe iOS



kqz.gov.al

PROCESI I REGJISTRIMIT

HAPI 2



Zgjedhësi **skanon dokumentin e identifikimit** (letërnjoftim ose pashaportën e lëshuar nga RSH)

Aplikacioni lexon nga dokumenti këto të dhëna: Numrin personal, emrin, mbiemrin, datën e lindjes, foton e dokumentit të identifikimit ose pashaportës


*për rastin e dokumenteve 'të dëmtuara' dhe/ose të paqarta app-i gjithsesi në pamundësi leximi do t'i japë mundësi zgjedhësit që këto të dhëna t'i japë manualisht.



kqz.gov.al

PROCESI I REGJISTRIMIT

HAPI 3




App-i hap kamerën frontale për të bërë **'face recognition'** të zgjedhësit e për ta kryqëzuar atë me foton që u skanua nga dokumenti i identifikimit si më lart.



kqz.gov.al

PROCESI I REGJISTRIMIT

HAPI 4




App-i për të shmangur 'mashtimet' dhe/ose gabimet; **sigurohet se fytyra që është shfaqur në kamera është vetë zgjedhësi** dhe jo një fotografi e tij duke përdorur teknologjinë 'user liveness check'.

* App do të verifikojë pamjen e zgjedhësit çdo herë kur ai/ajo e përdor atë.



kqz.gov.al

PROCESI I REGJISTRIMIT



Të dhënat e marra, app-i i përkthen në një **formë/formular elektronik**

PROCESI I REGJISTRIMIT

HAPI 5

Emër Mbiemër
Datëlindja
xx/xx/xxxx
Dokumenti
 Kartë ID (verifikuar)

email

numër telefoni

adresa e rezidencës

Pastro formën

Dërgo

Zgjedhësi përfundon regjistrimin duke dhënë këto të dhëna:

- **adresën email**
- **numrin e telefonit celular**
- **adresën e banimit jashtë vendit** (në rastin që e ka deklaruar atë tashmë në RKGjC),

*në rastin që **nuk e ka deklaruar ende adresën** në RKGjC, ka mundësinë ta deklarojë atë gjithsesi në këtë moment. Në këtë rast do duhet të ngarkojë **edhe një dokument që tregon lidhjen me shtetin ku ai/ajo jeton**, si psh një kontratë marrje me qira ose dokumenti i pronësisë së shtëpisë, kontrata e ujit/energjisë/gazit, kontrata e punës, të shkollimit, etj.

PROCESI I REGJISTRIMIT



App-i **komunikon në kohë reale me RKGjC** për të kontrolluar saktësinë e të dhënave që u përftuan nga skanimi i dokumentit të identifikimit dhe/ose që vendosi vetë zgjedhësi.

-nëse të dhënat janë të sakta, App-i do ta informojë zgjedhësin se është kandidat për tu përfshirë në listën e zgjedhësve që jetojnë jashtë vendit.

-nëse të dhënat nuk janë të sakta, App-i do ta informojë zgjedhësin se duhet t'i saktësojë ato dhe se nuk do të vazhdojë më tej me regjistrimin derisa ai/a jo t'i korigjojë ato respektivisht.



kqz.gov.al

PROCESI I REGJISTRIMIT

HAPI 6



Zgjedhësi **duhet të zgjedhë formën e tretë të autentifikimit** e cila do të aplikohet sa herë që ai akseson App-in.

Opsionet janë:

aplikacion Authenticator ose **një kod i përkohshëm unik 4-6 shifra**


Nëse zgjedh opsionin e dytë, do duhet të përcaktojë nëse kodin dëshiron ta marrë me email apo me sms në numrin e tij të celularit.



kqz.gov.al

PROCESI I REGJISTRIMIT

HAPI 7




Kjo metodë aplikohet menjëherë në këtë moment.



kqz.gov.al

PROCESI I REGJISTRIMIT

HAPI 8



Pas verifikimit/konfirmimit si më sipër, **zgjedhësi dërgon aplikimin e tij për tu regjistruar** dhe menjëherë njoftohet se:

- kërkesa u dërgua me sukses** (dritare pop-up si dhe email konfirmimi)
- i jepet nr unik i gjurmimit** të kërkesës së tij
- ai/ajo do të njoftohet** për rezultatin e shqyrtimit të kërkesës nga KQZ brenda afatit përkatës ligjor.



kqz.gov.al

SHQYRTIMI I KËRKESËS NGA KQZ



Sistemi qendror **analizon të dhënat** për të verifikuar saktësinë e tyre **duke komunikuar me bazat e të dhënave shtetërore** si RKGjC dhe/ose sisteme të tjera.



1




KQZ **vlerëson nëse personi në fjalë plotëson kushtet** për të qenë zgjedhës nga jashtë (nëse vendosen të tilla me akte ligjore dhe/ose nënligjore).



2



Nëse këto të dhëna përputhen, KQZ komunikon me DPGjC për përfshirjen e këtij zgjedhësi në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe **heqjen e tij/saj nga lista e zgjedhësve 'brenda vendit'** për këtë proces zgjedhor.



a



Në këtë rast, sistemi i **dërgon me e-mail** zgjedhësit njoftimin që është përfshirë në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit dhe se është hequr nga lista e zgjedhësve 'brenda vendit', **si dhe kredencilaet** që i japin mundësinë atij/asaj të marrë pjesë në votim. Kështu, **hapet "llogaria" personale** në sistem për të.




3



Nëse këto të dhëna nuk përputhen, sistemi do të njoftojë zgjedhësin **me email** për rezultatin e shqyrtimit **dhe arsyet e mospërputhjes/mosregjistimit**.


Pas këtij njoftimi, ai/ajo mund të **paraqesë ankesë sipas dispozitave** në aktet përkatëse të miratuar nga KQZ për këtë qëllim.



b

Propozimet Teknike për Votën e Diasporës
Procesi i Regjistrimit

Faleminderit !



**KOMISIONI QENDROR
I ZGJEDHJEVE**



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al